



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË

Kryesuese e Senatit
Prof.dr. Nurten Deva

Nr. Prot. 2721 Dt 20.11.2024

Në bazë të nenit 9, pika 5 dhe 6, të Rregullores 1670 të dt. 28.09.2021 për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, Senati i Universitetit "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 19.11.2024, mori:

VENDIM

- I. Për aprovimin e propozimeve të njëjësive akademike për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, sipas konkursit me nr.prot.2213 i publikuar me dt.03.10.2024 të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë për vitin akademik 2024/2025, si në vijim:

Fakulteti i Gjeoshkencave

1. **Frashër Brahimaj** - mësues për lëndët: Teknika e shpim-plasjes në miniera, Plasjet speciale dhe masive, Projektimi në shfrytëzim sipërfaqësor.
2. **Anullohet konkursi për pozitën:** Një mësues për lëndët: Makinat Minerare, Transporti në miniera, Menaxhimi i mbetjeve minerare, Mekanika e dherave, pasi askush nuk i plotëson kriteret.
3. **Vjosa Grapci** - asistent për lëndët: Kimi, Kimia inorganike, Kimia e përgjithshme.
4. **Argjend Hajra** - asistent për grup lëndësh në Gjeologji.
5. **Enes Muzaqi** - asistent për grup lëndësh në Vendburime Minerale.

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

1. **Anullohet konkursi për pozitën:** Një mësues për lëndët: Gjuha gjermane I dhe Gjuha gjermane II, për shkak se nuk ka aplikuar asnjë kandidat.
2. **Anullohet konkursi për pozitën:** Një asistent për lëndët: Gjuha gjermane I dhe Gjuha gjermane II, për shkak se nuk ka aplikuar asnjë kandidat.
3. **Anullohet konkursi për pozitën:** Një asistent për lëndën: Matematika I, pasi askush nuk i plotëson kriteret.
4. **Berat Sinani** - asistent për lëndët: Bazat e informatikës dhe Softueri aplikativ në inxhinierinë mjedisore;
5. **Arbnora Durmishaj** - asistent për lëndët: Mikrobiologjia, Biokimia e përgjithshme, Mikrobiologjia e ushqimit, Bazat e toksikologjisë, Toksikologjia e mjedisit, Fiziologjia e mikroorganizmave industrial, Toksikologjia e ushqimit, Kinetika e proceseve bioteknologjike, Kimia dhe teknologjia e drithërave
6. **Gonxhe Kajtazi** - asistent për lëndët: Materialet me prejardhje shtazore, Bazat e Inxhinierisë së reaktorëve, Kontrollimi i cilësisë së ushqimit, Shkenca e ushqimit I, Kontrolli i cilësisë së produkteve ushqimore, Teknologjia e verës, Inxhinieria ushqimore, Teknologjia e përpunimit të mishit dhe vezëve.

7. **Besijana Kurti** - asistent për lëndët: Kimia e mjedisit, Energjia dhe mjedisi, Burimet alternative të energjisë, Menaxhimi i hedhurinave, Inxhinieria e mbrojtjes së mjedisit, Proceset e riqarkullimit, Transporti i materieve të rrezikshme;
8. **Egzona Osmani** - asistent për lëndët: Trajtimi i ujërave të zeza I , Analiza e ndotësve të ajrit dhe ujit, 3. Trajtimi i ajrit të ndotur , Monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore , Monitorimi dhe pastrimi i gazeve , Trajtimi i ujërave të zeza II , Korrodimi dhe mjedisi , Ndotjet industriale;

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike

1. **Nexhat Bajrami** - mësimsdhënës për lëndët: Arkitektura dhe organizimi i kompjuterëve, Menaxhimi i bazës së të dhënave, Mikroprocesorët dhe Mikrokompjuterët, Modelimi dhe simulimi kompjuterik.
2. **Bujar Prokshi** - asistent për lëndët: Komponentët elektronike, Arkitektura dhe organizimi i kompjuterëve, Rrjetat kompjuterike, Siguria e Informacionit, Menaxhimi i bazës së të dhënave, Bazat e Inxhinierisë Elektrike, Mikroprocesorët dhe Mikrokompjuterët, Elektronikë Digjitale, Modelimi dhe simulimi kompjuterik.

Fakulteti Ekonomik

1. **Anulohet konkursi për pozitën:** Një mësimsdhënës për lëndën: Financa ndërkombëtare, pasi askush nuk i plotëson kriteret.
2. **Donika Aliu – Zhuja** - mësimsdhënës për lëndën: Lidershipi;

Fakulteti i Edukimit

1. **Melinda Mula** - mësimsdhënës për lëndët: Metodologji e mësimit të matematikës I dhe II.
2. **Hasan Mlinaku** - mësimsdhënës për lëndën: TIK në arsimin Fillor.
3. **Vita Guhelli** - mësimsdhënës për lëndët: Bazat e arsimit muzikor, Interpretim me instrumente.
4. **Vita Guhelli** - asistent për lëndët: Interpretim me instrumente, Bazat e arsimit muzikor.
5. **Blerthë Kaçiu** - asistent për lëndët: Edukim fizik me metodologji.

Fakultetit i Gjeoshkencave, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore, Fakulteti Ekonomik, Fakulteti i Edukimit dhe Fakulteti Juridik

1. **Erëza Rushiti** - asistent për lëndët Gjuhë angleze I dhe II.
- II. Kandidatët të cilët janë përzgjedhur për angazhim në mësimsdhënie dhe ushtrime, do të pajisen me kontrata varësisht prej fondit të orëve që posedojnë për vit akademik. Angazhimi sipas këtij konkursi nuk nënkupton pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.
 - III. Kontratat e punës për stafin e propozuar për angazhim, sipas raporteve të komisioneve të njëjësive akademike, do të përpilohen sipas dispozitave ligjore. Nënshkrimi i kontratave për angazhim do të bëhet vetëm pas konstatimit të normës së orëve dhe grupeve që do të formohen pas pranimit të studentëve. Kontrata do të bëhet për vit akademik, ose një semestrale nëse kandidati është i angazhuar vetëm për një semestër akademik, duke përfshirë edhe obligimet, që dalin nga procesi mësues.
 - IV. Bashkëpunëtorët e jashtëm të cilët kanë marrëdhënie pune, para nënshkrimit të kontratës duhet të sjellin dokumentin që dëshmon miratimin nga udhëheqësi më i lartë administrativ

ku është i punësuar me kontratë primare (me kohë të plotë), konform nenit 4, pika 4.1, të Rregullores 09/2023 për shtesën funksionale.

- V. Për pozitat e anuluar, menaxhmenti i njësisë akademike obligohet të bëjë zgjidhje adekuate, sipas nenit 5, paragrafi 2 të Rregullores 1670, dt. 28.09.2021.
- VI. Dekanët e njësive akademike mbajnë përgjegjësi ligjore për rastet e konflikteve të interesit dhe nepotizmit për kandidatët e përzgjedhur.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Këshillë Juridike: Kandidatët e pakënaqur mund të kontestojnë këtë njoftim në Gjykatën kompetente, në afat prej 15 ditësh nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UIBM;
2. Menaxhmentit UIBM;
3. Fakulteteve;
4. Zyrës për çështje akademike;
5. Zyrtarit për paga;
6. Zyrës së personelit;
7. Zyrës ligjore



Prof.dr. Nurten Deva

Nurten Deva
Kryesuese e Senatit